



VENDIM

Nr. 76 Datë 15.10.2009

**PËR
MOSMIRATIMIN E KONTRATAVE TE NEGOCIUARA NGA
SHOQERIA OSSH SH.A ME SHOQERITE RUDNAP GROUP AD DHE
ENERGY FINANCING TEAM AG**

Në mbështetje të nenin 9 të ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, pikës 2.10 te Vendimit te Bordit te Komisionereve nr.42 date 25.05.2009 “Rregullat dhe procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.10.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e OSSH sh.a si dhe relacioniet e Drejtorive teknike ne ERE

Konstatoi se :

Pas shqyrtimit te procedures se prokurimit te zhvilluar nga shoqeria OSSH sh.a si dhe duke ju referuar Rregullave dhe procedurave standarte te prokurimit te energjise elektrike nga OSSH sh.a, ne procesin e negociimit nuk eshte realizuar kushti qe çmimi i pranuar ne kontrate te jete me i ulet se çmimi i ofruar ne tenderin e anuluar perpara se te fillonte procedura e negociimit

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Mosmiratimin e kontratave te negociuara nga shoqeria OSSH sh.a me shoqerite RUDNAP GROUP AD dhe Energy Financing Team AG.
2. Ngarkohet OSSH sh.a te marrë masa për sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve per vitin 2010 sipas Rregullave dhe Procedurave Standarte të Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 76 Datë 15 .10 .2009

**PËR
MOSMIRATIMIN E KONTRATAVE TE NEGOCIUARA NGA
SHOQERIA OSSH SH.A ME SHOQERITE RUDNAP GROUP AD DHE
ENERGY FINANCING TEAM AG**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____